VENDIM
Nr. 92, datë 24.4.2025

MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË "5GX ENERGY" SHPK PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN (NËPËRMJET VENDOSJES SË BARRËS SIGURUESE) TË ASETEVE FIKSE TË SAJ

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa "a", dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.4.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 35/14 prot., datë 23.4.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, "Mbi kërkesën e shoqërisë '5GX Energy' sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese) të aseteve të paluajtshme të saj",

konstatoi se:

- Për qëllime të shqyrtimit të këtij aplikimi janë ndjekur procedurat dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Paraqitja e kërkesës për autorizim:

- Shoqëria "5GX Energy" sh.p.k. më datë 8.1.2025, paraqiti kërkesën për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese) të aseteve fikse të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj "Tirana Bank" sh.a.

2. Fillimi i procedurës për transferimin e aseteve:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 26, datë 27.1.2025, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë.

- ERE ka njoftuar shoqërinë dhe MIE-n në lidhje me këtë vendim nëpërmjet shkresës nr. 35/5 prot., datë 6.2.2025.

3. Procedura vijuese dhe vlerësimi i dokumentacionit:

- Me shkresat nr. 35/3 prot., dhe nr. 35/4 prot., datë 3.2.2025, ERE njoftoi shoqërinë dhe "Tirana Bank" sh.a. për zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 13.2.2025, duke i kërkuar shoqërisë plotësimin e dokumentacionit të munguar, përfshirë: gjendjen financiare në momentin e paraqitjes së kërkesës, marrëveshjen paraprake me listën e aseteve, çdo transferim të mëparshëm, si dhe qëndrimin lidhur me faktin që marrëveshja është nënshkruar pa marrë më parë autorizimin e ERE-s.

- Gjatë seancës, përfaqësuesit e bankës dhe të shoqërisë deklaruan se do të anulonin marrëveshjen ekzistuese të barrës siguruese mbi asetet e shoqërisë, do të kryenin fshirjen e saj nga Regjistri i Barrës Siguruese dhe do të paraqisnin pranë ERE-s një marrëveshje të re, e cila do t'i nënshtrohej më parë miratimit të institucionit.

- Pas seancës dëgjimore të datës 13.2.2025 dhe komunikimeve shkresore (shkresë nr. 35/6 prot., datë 18.2.2025, shkresë nr. 35/7 prot., datë 19.2.2025), me shkresën nr. 35/8 prot., datë 27.2.2025, shoqëria plotësoi pjesërisht dokumentacionin dhe kërkoi pezullimin e procedurës deri më 17.3.2025.

- Në datën 17.3.2025, "Tirana Bank" sh.a., me shkresën nr. 35/9 prot. dhe shoqëria, me shkresën nr. 35/10 prot. dorëzuan marrëveshjen e re siguruese nr. 534 rep., nr. 384 kol., datë 12.3.2025 dhe vërtetimin e fshirjes nga RBS-ja të marrëveshjes së mëparshme nr. 2691 rep., nr. 1731 kol., datë 10.12.2024.

- Në vijim të shkresës nr. 35/11 prot., datë 18.3.2025, të ERE, shoqëria me shkresën nr. 35/12 prot., datë 20.3.2025, depozitoi marrëveshjen e re siguruese nr. 533 rep., nr. 383 kol., datë 12.3.2025, për vendosjen e barrës së radhës së parë në favor të "Tirana Bank" sh.a.

4. Zgjatja e vendimmarrjes së Bordit

- Për qëllime të vlerësimit të gjendjes financiare të kompanisë dhe efektet e pritshme të këtij transferimi në vazhdimësinë e aktivitetit, me vendimin nr. 72, datë 8.4.2025, Bordi i ERE-s vendosi të zgjasë me 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë "5GX Energy" sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese) të aseteve fikse të saj si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj "Tirana Bank" sh.a.

- Pas shqyrtimit të gjithë dokumentacionit të depozituar të shoqërisë "5GX Energy" sh.p.k., në lidhje me këtë aplikim, ka lindur nevoja që shoqëria/banka të saktësojë/depozitojë amendimin përkatës të kontratës bazë të kredisë së nënshkruar me "Tirana Bank" sh.a.

- Referuar nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Bordi i ERE-s vlerëson zgjatjen me 30 ditë të vendimmarrjes në lidhje me kërkesën e shoqërisë "5GX Energy" sh.p.k. për transferimin e aseteve fikse të saj nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë "5GX Energy" sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese) të aseteve fikse të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj "Tirana Bank" sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "5GX Energy" sh.p.k. dhe "Tirana Bank" sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti